



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3942 Prot  
Shkodër, më 26.02.2024



FONDACIONI FIRDEUS

Nr. 234 Prot  
Tiranë, më 26.2.2024

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot me datë 26/2/2024 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve:

**Bashkia Shkodër**, me Kryetar Z.Benet BECI, përfaqësuar në këtë marrëveshje me vendim delegimi nr.514, datë 29.12.2023 “Për delegim kompetence” nga Zv/Kryetari z.Onid Bejleri, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rr. 13 dhjetori, Shkodër, këtej e tutje i cilësuar si “Bashkia”.

Dhe

**Fondacioni ‘FIRDEUS’**, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me vendimin nr. 576 datë 15.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS L716274530, me seli në Rruga “Elbasanit”, 333, 1003, Sauk, Tiranë, përfaqësuar nga Z.Illir Hoxholli në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit FIRDEUS, identifikuar me numër personal H40718122U, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në vijim referuar si “Fondacioni”.

Bashkia dhe Fondacioni do të referohen në vijim edhe si “Pala” ose “Palët”.

*Duke qenë se Palët:*

*Vlerësojnë* rëndësinë e mbështetjes dhe strehimit të personave të moshuar dhe në nevojë strehimi e përkujdesjeje;

*Marrin në konsideratë* politikat e mbrojtjes sociale të Bashkisë Shkodër dhe fokusin e aktivitetit të Fondacionit Firdeus në drejtim të mbrojtjes së shtresave në nevojë.

*Synojnë* të kontribuojnë dhe të përmirësojnë kushtet e jetesës për të moshuarit në nevojë për strehim dhe përkujdesjeje;

*Njohin* eksperiencën e palëve respektive në drejtim të asistencës për shtresën e të moshuarve;

Konfirmojnë angazhimin institucional dy palësh në bashkëpunimin për ofrimin e shërbimeve prë të moshuarit në Bashkinë e Shkodrës.

## NENI 1 BAZA LIGJORE

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me:

- Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” të ndryshuar;
- Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar ;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, te ndryshuar;
- VKM-në nr.518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.
- VKB -së nr.55,datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”.


## NENI 2 OBJEKTI I MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë dhe Fondacionit Firdeus për ofrimin e shërbimeve rezidenciale për të moshuarit e Bashkisë Shkodër.

## NENI 3 ANGAZHIMET E PALËVE

### Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë

1. Në rast shfaqjeje interesi nga subjekte në nevojë për strehim, të pamundur për të përfituar nga institucionet rezidenciale për të moshuar publike pas verifikimit rast pas rasti dhe pas informimit për rregullat që duhen zbatuar në qendrën rezidenciale e referon rastin pranë Fondacionit.
2. Për rastet e referuara, asiston Fondacionin në verifikimin e kërkesave të personave që kërkojnë të strehohen në qendrën rezidenciale.
3. Bashkia Shkodër sipas mundësisë së saj organizon aktivitete argëtuese dhe/ose përfshin rezidentët në aktivitetet e organizuara nga ajo.
4. Merr përsipër shpenzimet e varrimit për personat pa të afërm dhe/ose të braktisur (maksimalisht tre raste në vit, sipas procedurave përkatëse) të parashikuara në VKB nr.55,datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, Shërbime varrimi për raste të veçanta, programi : P06260.





## Rolet dhe përgjegjësitë e Fondacionit

1. Të ofrojë kushte të përshtatshme për akomodim për personat e moshës së tretë, në qendrën e tyre rezidenciale “Si në shtëpi”, me nr. liçence LN-3667-02-2022, e cila ndodhet në rrugën “Riza Dani”, Nr. 2 të qytetit të Shkodrës.
2. Të sigurojë paketën e shërbimeve bazë: higjenë, mensë sociale, fjetje, kujdes shëndetësor e psiko-social.
3. Të ofrojë shërbime këshilluese, ndërmjetësuese lidhur me statusin familjar, strehim social dhe aspekte ligjore.
4. Të kontribuojë për të parandaluar braktisjen e personave të moshës së tretë.
5. Të ofrojë asistencë mjekësore bazë në të cilin përfshihen: kontroll i përgjithshëm i gjendjes shëndetësore, shërbime në nivel mjekësor dhe infermieror me staf të kualifikuar.
6. Të marrë përsipër krijimin e kushteve për shoqërim, argëtim dhe kohë të lirë të rezidentëve.

## NENI 4

### PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

1. Palët do të përdorin informacionin e marrë sipas kësaj marrëveshje vetëm për qëllim të ushtrimit të funksioneve të tyre ligjore, dhe vetëm brenda kuadrit të kësaj marrëveshje.
2. Përgjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje dhe pas përfundimit të saj, pa asnjë kufizim në kohë apo në vend, Palët do të mbajnë konfidencial çdo informacion apo dokument, të shkëmbyer mes tyre lidhur me këtë marrëveshje, aktivitetin, funksionimin, financat e secilës Palë, dhe në përgjithësi çdo informacion apo të dhënë me të cilën palët janë njohur apo u është bërë e ditur për shkak të kësaj marrëveshje.
3. Palët do të ushtrojnë të gjithë kujdesin e arsyeshëm për të parandaluar rrjedhjen e informacionit tek çdo person juridik apo fizik i pa-autorizuar për të marrë këtë lloj informacioni, me përjashtim të rasteve kur ky informacion kërkohet për shkak të kërkesave të ligjit. Në rast të detyrimit për të dhënë te palë të treta, çdo lloj informacioni dokumenti apo të dhënë, për shkak të kërkesave të ligjit, do të kërkohet miratimi paraprak me shkrim i përfaqësuesve respektiv të secilës Palë.

## NENI 5

### RUAJTJA, PËRPUNIMI DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

1. Palët bien dakort se për efekt të kësaj marrëveshje, në rast se do të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale, do ta bëjnë këtë në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, te ndryshuar.



2. Palët bien dakort dhe garantojnë respektivisht njëra-tjetrën se të dhënat personale të çdo personi që do të përfshihet në shërbimet/projektet e zbatuara nga Palët në kuadër të kësaj marrëveshje, do të mbledhen, ruhen dhe përpunohen me anë të mekanizmave teknologjike dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” te ndryshuar.
3. Palët bien dakort dhe garantojnë respektivisht njëra-tjetrën se nuk do të përdorin apo bëjnë publike të dhënat personale të mbledhura për efekt të zbatimit të kësaj marrëveshje apo çdo marrëveshje që do të lidhet në vijim midis Palëve, në zbatim të saj dhe detyrimeve sipas ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” te ndryshuar.
4. Palët bien dakord se publikimi i fotove apo videove të bëra gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje do të bëhet vetëm me konsensus të të dyja Palëve. Nuk do të publikohen foto të cilat nuk janë dinjitoze.

#### NENI 6

#### ZBATIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qënë partnerë në zbatimin e saj dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tij.

#### NENI 7

#### KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do te jete e vlefshme deri me datë 31.12.2024.

#### NENI 8

#### PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Secila nga palët mund të përfundojë këtë marrëveshje në rastet kur:

- a. Mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
- b. Shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit;
- c. Palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes së bashkëpunimit;
- d. Për forcë madhore.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e bashkëpunimit deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

**NENI 9**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët, në të kundërt palët kanë të drejtën t'i drejtohen për zgjidhjen e tyre Gjykatës kompetente.

**NENI 10**  
**GJUHA MARREVESHJES**

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe.

**NENI 11**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

Palët përgjigjen reciprocisht për përmbushjen e drejtave dhe detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive.

**NENI 12**  
**HYRJA NË FUQI**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

Hartohet në 4 kopje të barazvlefshme, nga dy kopje për secilën palë.

**PËR**  
**BASHKINË SHKODËR**  
**KRYETAR**  
**Z. Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**  
**Zv/KRYETAR**  
**Onid BEJLERI**



**PËR**  
**FONDACIONIN FIRDEUS**  
**DREJTOR EKZEKUTIV**  
**Z. Ilir HOXHOLLI**

